

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS** – kolegji i përberë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit ‘F. M. K.’ sh.p.k. nga P., kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me bazë juridike anulim i vendimit doganor nr. ...., datë ...., lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA-UZH nr.377/2016 datë 07.03.2017, në seancën e mbajtur më 08.02.2018, mori këtë

### **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit ‘F. M. K.’ sh.p.k, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.377/2016 dt.07.03.2017.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.377/2016 dt. 07.03.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit ‘F. M. K.’, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dep.administrativ, Divizioni fiskal, A-U nr. 1324/2014 datë 17.10.2016, me të cilin është refuzuar e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit për anulimin e vendimit e të paditurës-Doganës së Kosovës, .... datë .....

Paditësi i ka paraqitur kësaj gjykate kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur, duke theksuar se aktgjykimi i kontestuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të së drejte materiale dhe të dispozitave procedurale, me propozim që të aprovohet kërkesa, ndërsa aktgjykimet e kontestuara, ai i Gjykatës së Apelit AA. UZH. nr.377/2016 dt. 07.03.2017 dhe i Gjykatës Themelore - Dep.administrativ / Divizioni fiskal A.U. nr. 1324/2014 dt. 17.10.2016, të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme mbajti seancën në përputhje me nenin 53 të LKA, ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar, vlerësoi pretendimet e paraqitur në kërkesë dhe, pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës konstatoi:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshme të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.377/2016 dt. 07.03.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit 'F. M. K.'sh.p.k, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dep. administrativ /Div.fiskal A.U. nr. 1324/2014 dt.17.10.2016, me të cilin është refuzuar kërkespadia e paditësit për anulim të vendimit e të paditurës - Dogana e Kosovës nr. .... dt.....

Me rastin e shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Supreme vlerëson si të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së dytë me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, për arsye se i njejtë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave ligjore siç pretendon paditësi.

Me nenin 291 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109 parashikohet se kërkesat për rishqyrtim të vendimit ushtrohen pranë Doganës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit. Në paragrafin 3 të këtij neni, Dogana nga dita e njoftimit lidhur me ankesën, do të përgjigjet me shkrim në afat prej 60 ditësh. Andaj, kjo Gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejtë dhe bazuar në dispozitat ligjore kanë konstatuar se organi i paditur drejtë ka vepruar kur ka vendosur ta hedhë poshtë si të pasafshme kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve R ....., R....., R....., R.... të datës ....., si dhe vendimeve R....., R....., R.... të datës ..... të Zyrës Doganore Hani i Elezit, meqenëse paditësi vendimet i ka pranuar me datën .... dhe ....., ndërsa kërkesa për revizion është paraqitur me ....., pra jashtë afatit ligjor.

Neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 parashikon se vlera doganore e mallrave është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar në raport me faturat përcjellëse të mallit apo të Deklaratave Unike Doganore, pra transaksioni bankar është prova vendimtare që vërteton se vlera e mallit është paguar sipas faturave të mallit. Prandaj, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatave të instancës më të ulët, për arsye se paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlera e transaksionit e paguar, siç parashihet në nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109.

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se pohimet në kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm janë të pabazuara sepse ato nuk ndikojnë në vërtetimin tjetër të gjendjes faktike nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkallës së dytë. Aktgjykimi i shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, përmban arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet vendimtare. Gjykata Supreme vlerëson se e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të paditësit.

Nga sa u parashtua dhe në bazë të nenit 54 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
ARJ-UZVP nr. 32/2017 datë 08.02.2018

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit  
Nebojsa Boriçiq,

Përktheu,  
Ferid Abazi